

Shoqeria "NOA DEVELOPMENT" sh.p.k
Bulevardi "Deshmoret e Kombit"
Tirane
NIPT L 42203032 I

Tirane me, 26/12/2022

V E N D I M Nr 3

I Ortakeve te Shoqerise

Sot me date 26/12/2022, ne seline e shoqerise "Noa Development" shpk, u mbajt Asamblea e Pergjithshme e Ortakeve e cila ne baze te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare", te Aktit te Themelimit dhe Statutit te Shoqerise u mblodh ne menyre urgjente per te diskutuar dhe vendosur sa me poshte vijon:

1. Anullim i vendimit nr.1 date 11/09/2022 per rritjen e kapitalit;
2. Korrigjim dhe percaktim i sakte i kapitalit nepermjet zvogelimit;
3. Emerimi i Audituesit Ligjor per korrigjimin e kapitalit nepermjet zvogelimit;

Ne mbledhje jane te pranishem ortaket e shoqerise, z.Gentian Sula, i cili perfaqeson 0.04% te pjeseve te kapitalit te shoqerise dhe perfaqesuesi I shoqerise Zip Cloud shpk me NUIS ; L61531022M, e cila zoteron 99.96% te pjeseve te kapitalit te shoqerise. Asamblea e Ortakeve procedoi me diskutimin e pikeve sipas rendit te dites.

Ne lidhje me piken e pare te rendit te dites Shoqeria me vendimin nr.1 te dates 11/09/2022 ka marre vendim per rritjen e kapitalit te shoqerise ne Shumen 229,877,069 leke, vlere e cila rezulton hua e marre nga shoqeria Zip Cloud shpk, e cila do te behet pjesemarrese ne kapital tek shoqeria Noa Development shpk.

Ky vendim eshte depozituar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit me date 11/10/2022. Nga sa rezulton nga dokumentat e perdorur per marrjen e vendimit per rritjen e kapitalit, konstatohet se shuma e rritjes se kapitalit eshte e pasakte dhe per rrjedhoje vendimi i marre eshte i pavlefshem dhe si i tille duhet te anulohet.

Persa i perket pikes se dyte te rendit te dites, dhe ne mbeshtetje me sa u vendos ne diskutimin e pikes se pare ,eshte e nevojshme te behet korrigjimi i shumes se rritjes te kapitalit qe ka ardhur si pasoje e veprimit te pasakte me vendimin nr. 1 te dates 11/09/2022. Veprimi i pasakte e kthen kapitalin e shoqerise ne shumen 174,600,000 leke. Kjo procedure kerkon zvogelimin e kapitalit nepermjet nje raporti te hartuar nga nje Auditues Ligjor.

Persa i perket pikes se trete te rendit te dites, dhe ne mbeshtetje me sa u diskutua ne piken e dyte te rendit te dites, ortaket propozojne emerimin e zj. Brunilda Stefa, Auditues Ligjor me numer licence 182 date 15/10/2008, te procedoje me korrigjimin e kapitalit nepermjet zvogelimit.

Ne perfundim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve dhe duke mos patur pike tjeter per te diskutuar , ortaket e shoqerise

V E N D O S E N

1. Anullim i vendimit te shoqerise nr.1 date 11/09/2022, per rritjen e kapitalit te shoqerise ne Shumen 229,877,069 leke si nje vendim i pavlefshem.
2. Korrigjim dhe saktetim i shumes se kapitalit, i cili nga shuma 229,977,069 leke duhet te behet ne shumen 174,600,000 leke.
3. Emerimin e Audituesit Ligjor, Zj. Brunilda Stefa , mbajtes i kartes se identitetit me numer personal G 65702149 J, me Licence nr 182 date 15.10.2008, per te pergatitur raportin dhe modalitetet e korrigjimit te shumes te kapitalit te shoqerise nepermjet zvogelimit.
4. Ngarkohet administratori i shoqerise zj. Eranda Nepravishta per depozitimin e ketij Vendimi prane Qendres Kombetare te Biznesit .

Ortaket e Shoqerise

Gentian SULA

Gentian Sula



**ZIP Cloud shpk
Gentian SULA**

Gentian Sula



Shoqeria "NOA DEVELOPMENT" sh.p.k
Bulevardi "Deshmoret e Kombit"
Tirane
NIPT L 42203032 I

Tirane me, 30/12/2022

V E N D I M N r 2

I Ortakeve te Shoqerise

Sot me date 30/12/2022 ne seline e shoqerise "Noa Development" shpk, u mblodh Asamblea e Pergjithshme e Ortakeve per te diskutuar dhe vendosur sa me poshte vijon:

1. Miratim i raportit te Audituesit Ligjor per korrigjimin dhe sakesimin e kapitalit nepermjet zvogelimit.
2. Zvogelimi i kapitalit si pasoje e sakesimit dhe korrigjimit.

Ne mbledhje jane te pranishem ortaket e shoqerise, z.Gentian Sula, I cili perfaqeson 0.04% te pjeseve te kapitalit te shoqerise dhe perfaqesuesi I shoqerise Zip Cloud shpk me NUIS ; L61531022M, e cila zoteron 99.96% te pjeseve te kapitalit te shoqerise. Asamblea e Ortakeve procedoi me diskutimin e pikeve sipas rendit te dites.

Persa I perket pikes se pare te rendit te dites, Shoqeria me date 26/12/2022 ka marre vendim nr. 3 per anullimin e vendimit nr.1 date 11/09/2022 nepermjet te cilit eshte bere rritja e kapitalit te shoqerise. Po me vendimin e dates 26/12/2022 eshte emeruar Audituesi Ligjor, Brunilda Stefa , e cila eshte ngarkuar me detyren e hartimit te raportit per zvogelimin e kapitalit te shoqerise si pasoje e korrigjimit dhe sakesimit qe duhet te behet pas anullimit te vendimit te dates 11/09/2022. Audituesi Ligjor paraqet per miratim perpara Asamblese raportin e zvogelimit te kapitalit, nepermjet te cilit, kapitali i shoqerise korrigjohet dhe arrin ne Shumen 174,600,000 leke.

Persa i perket pikes se dyte te rendit te dites, dhe ne mbeshtetje me raportin e paraqitur nga Audituesi Ligjor, rezulton qe kapitali i shoqerise eshte korrigjuar nepermjet zvogelimit ne shumen 174,600,000 leke.

Ne perfundim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve dhe duke mos patur pike tjeter per te diskutuar , ortaket e shoqerise

V E N D O S E N

1. Miratimin e raportit te Audituesit Ligjor, zj. Brunilda Stefa, per zvogelimin e kapitalit te shoqerise nepermjet korrigjimit dhe sakesimit te ardhur si pasoje e

anullimitte vendimit nr. 1 te dates 11/09/2022. Korrigjimi i shumes do te behet duke zvogeluar kapitalin per 55,377,069 leke dhe duke arritur shumen **174,600,000 leke**.

2. Miratimi i kapitalit te korrigjuar dhe sakteluar nepermjet zvogelimit ne shumen **174,600,000 leke** e ndare me kontributin e ortakeve si me poshte:

- Shoqeria ZIP CLOUD shpk 174,500,000 leke (99.94 % te pjeseve te kapitalit)
- Gentian SULA 100,000 leke (0.06 % te pjeseve te kapitalit)

3. Ngarkohet administratori i shoqerise zj. Eranda Nepravishta per depozitimimin e ketij Vendimi dhe te raportit te Audituesit Ligjor prane Qendres Kombetare te Biznesit.

Ortaket e Shoqerise

Gentian SULA

Gentian Sula



ZIP Cloud shpk
Gentian SULA

Gentian Sula

